

Më datën 1 Shkurt 2022, në mjediset e Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër u zhvillua analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit (DABSH), e cila u fokusua në prezantimin e rezultateve të Departamentit për vitin 2021, por duke paraqitur gjithashtu edhe problematikat e shfaqura, si dhe sfidat e për të ardhmen.

Të pranishëm në këtë analizë ishin Drejtore e Përgjithshme znj. Marjola Llanaj, Sekretare e Përgjithshme znj. Valbona Gaxha, zv/Rektore Prof.as.PhD Paulina Hoti, si dhe pedagogë, staf dhe studentë të Universitetit të Shkodrës. Pas fjalës së hapjes së znj. Llanaj, zv/Rektorja e Universitetit “Luigj Gurakuqi” përshëndeti të pranishmit, duke vlerësuar këtë aktivitet si një mundësi për t’u njohur konkretisht me fushëveprimin e KLSH-së, përvojën dhe bashkëpunimin, të cilat shërbejnë veçanërisht për Fakulteti Ekonomik dhe Juridik të këtij universiteti.



Më pas, Drejtori i Departamentit z. Gjovalin Preçi, paraqiti raportin mbi veprimtarinë e Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2021, në të cilin përveç rezultateve të auditimeve apo sfidave për të ardhmen, përmendi edhe faktin se KLSH, nëpërmjet kryerjes së analizave në universitete po vitalizon praktikën e bashkëpunimit me institucione akademike, e cila është nevoja e ndërsjellë që palët kanë për informacion, në funksion të rritjes së besimit të publikut në institucionin e KLSH-së.

Gjatë vitit 2021 për DABSH ishte planifikuar fillimisht kryerja e 15 auditimeve nga të cilat janë realizuar 22, si dhe audituesit janë angazhuar në 13 auditime të tjera jashtë departamentit. Në auditimet e evaduara të vitit 2021, 17 prej tyre kanë qenë auditime përputhshmërie, 3 auditime të kombinuara përputhshmërie dhe financiar, si dhe dy auditime tematike. Në vlerësim të situatës, materialitetit, përhapjes së parregullsive dhe impaktit të tyre në miradministrimin e financave publike, nga 22 auditimet të kryera, janë dhënë opinion për 19 prej tyre: 1 opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes, 9 opinione të kualifikuara, 9 opinione të kundërta. Në fjalën e tij, Drejtori i Departamentit vuri në dukje se treguesi i lartë i opinioneve të kundërta në masën 47 % tregon se në numër të konsiderueshëm subjektet e audituara kanë shfaqur mangësi të theksuara në menaxhimin ekonomik dhe financiar të veprimtarisë tyre, me pasoja në frenimin e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

Në vitin 2021 për përmirësimin e gjendjes së subjekteve të audituara janë lënë gjithsej 9 akte për ndryshime apo përmirësime ligjore në 6 subjekte, 316 masa organizative, 12 masa për shpërblim dëmi në vlerën prej 168,877.8 mijë lekë, 34 masa për efekte negative në menaxhimin me ekonomikitet, efience dhe efektivitet, në vlerën prej 1,029,159 mijë lekë. Nga auditimet e kryera në DPD, dhe në DRT Durrës, Fier, Korçë dhe Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj janë evidentuar të ardhura tatimore të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën prej 20,683,456.7

mijë lekë. Gjithashtu, në vijimi të përpjekjeve për të ndryshuar klimën e mos ndëshkueshmërisë, janë rekomanduar masa disiplinore dhe administrative për ndëshkimin e personave të cilësuar përgjegjës në raportet tona të auditimit duke rekomanduar masa administrative dhe masa disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”.



Ndër dobësitë e shfaqura gjatë vitit të mëparshëm një vëmendje e shtuar do t'i kushtohet hartimit të programit të auditimit si dhe dokumenteve të raportimit të auditimit në mënyrë që ato të jenë të plota, të sakta, objektive, të bindshme, të qarta, koncize, dhe me një pamje të përshtatshme të kuptueshme edhe për opinionin publik.

Në përfundim u paraqitën objektivat për vitin 2022 si më poshtë:

- Realizimin e planit të auditimeve në afatet e përcaktuara, në funksion të përbushjes së detyrimit kushtetues dhe ligjor për paraqitjen në Kuvend të Raportit për zbatimin e buxhetit;
- Përmirësimi i cilësisë së auditimit, si një sfidë e përhershme dhe e të gjitha SAI-ve;
- Përpjekjet maksimale për zbatimin sa më të plotë të ISSAI-ve, nëpërmjet trajnimeve të kësaj fushe, si dhe të përvojave më të mira;
- Zhvillimin dhe përvetësimin e trajnimeve specifike për aftësimin e audituesve të Departamentit në fushën e grumbullimit të të ardhurave tatimore dhe doganore;
- Vijimi i misionit në luftën kundër korrupsionit nëpërmjet të masave të rekomanduara.

DABDH për të ardhmen synon rritjen e impaktit të veprimtarisë audituese të Departamentit, duke konsoliduar auditimin e përputhshmërisë dhe auditimin financiarë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit si dhe përvetësimin e metodologjive dhe standardeve të aplikueshme në përputhje me praktikën më të mira, nxitjes dhe promovimit të vlerave të larta profesionale të audituesve, duke vënë integritetin si vlerë themelore.



Raporti i Drejtorit të Departamentit u pasua me disa prezantime të auditimeve kryesore si, ai i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Një prezantim tjetër ishte dhe ai i këndvështrimit për KLSH nga audituesit e rinj duke paraqitur disa aspekte (qasjet) mbi punën institucionale nga pikëpamja e audituesve që i janë shtuar rishtazi departamentit.

Seksioni i fundit i këtij aktiviteti ju rezervua pyetjeve dhe diskutimeve të të pranishmëve nga universiteti mbi prezantimet e stafit të KLSH-së. Analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit përfundoi me fjalën përmbyllëse të Drejtores së Përgjithshme, znj. Marjola Llanaj.